

Jo reduktimit të drejtave dhe pagave të migrantëve!

Kundër dumpingu në paga

Me shumë kontrolle dhe sanksione

2

Barazia në paga për gra

Përmes implementimit të ligjit!

3

Mësimi i gjuhës amtare

Manifestim më 18 janar 2014

4

Nr. 7 | dhjetor 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Iniciativa popullore «kundër imigrimit masiv»

Jo iniciativës të imigrimit masiv



Pamje nga kartolinat e kampanjës së sindikatës Unia në lidhje me iniciativën në fjalë

Më 9 shkurt populli zviceran do të votoj për iniciativën e SVP-së (shkurtesa në gjermanisht e Partisë Popullore të Zvicrës) «kundër imigrimit masiv». Ky shabllon dokument ksenofob dëshiron që migracionin ta rregulloj përmes kontingjentëve. Provon të shesë kontingjentet si zgjidhje të të gjitha problemeve. Ksenofobia dhe përjashtimi e izolimi nuk janë zgjidhje: Ne kemi nevojë për masa shoqërore shtesë të mira dhe të fuqishme (shkurtesa në gjermanisht: FlaM). Andaj ne më 9 shkurt themi JO!

Përsëri edhe njëherë tjetër votuesit zviceranë janë të ftuar të votojnë për një dokument ksenofob, i cili argumenton sikur iniciativa Schwarzenbach e viteve 1970-ta, se në Zvicër ka tepër të huaj.

Numrat maksimal dhe «përparsi zviceranëve»

Iniciativa e SVP-së «kundër imigrimit masiv» parasheh që migracioni në Zvicër të «drejtohet» përmes numrave maksimal. Në tregun e punës bile duhet të vlejë përparësia për zviceranët/ët. Zvicra sipas tekstit të iniciativës nuk duhet të ketë të drejtë të nënshkruaj marrëveshje ndërshtetërore, të cilat bien ndesh me përmbajtjen e iniciativës. Me këtë nuk do vlenet edhe marrëveshje bilaterale me BE-në mbi qarkullimin e lirë të njerëzve.

Migrantët si fajtor kujdestar

SVP-ja argumenton se qarkullimi i lirë i njerëzve me BE-në ka shkaktuar imigracionin masiv. Ky imigracion masiv i migrantëve qon në rritjen e qirasë së banimit, tejmbushje të trenave, dhe dumping në paga. Fajtor për gjithçka pra janë migrantët. Çka përpiket të fshehtë SVP-ja: edhe më herët ka pasur imigrim shumë të lartë. Edhe më të lartë se tani, gjegjësisht gjithmonë kur ky vend i kanë shkuar punët mirë.

Pa migrantë nuk ka mirëqenie

Migrantët vijnë pasi që ata ftohen. Ata janë të pazëvendësueshëm sikur në përkujdesje, hulumtim, apo në gastronomi. Ata vijnë pasi ka vende pune. Dhe migrantët kontribuojnë shumë për mirëqenie të vendit.

Qysh para luftës së parë botërore kur gjithashtu kishte qarkullim të lirë të njerëzve, profesionistët imigrantë ishin ata që në Zvicër prunë inovacionin dhe me këtë edhe mirëqenien. Kontingjentet përkundrazi shkatërronë inovacionin dhe zhvillimin e mëtejshëm.

Fundi i qarkullimit të lirë të njerëzve

Fundi i qarkullimit të njerëzve do të qonte në një kthim tjetër mbrapa. Qarkullimi i lirë i njerëzve falë angazhimit të sindikatave qoj tek fuqizimi i masave përcjellëse shtesë. Këto mundësojnë që të kontrollohen kushtet e punës. Natyrisht se qarkullimi i lirë i njerëzve nuk zgjidh problemin e shtypjes së pagës.

Më shumë KKP, më shumë kontrolle, masa më të mira shtesë

Vetëm KKP-të e obligueshme, pagave minimale dhe kontrolleve të mira sigurojnë dhe mbrojnë pagat dhe garantojnë kushtet e punës. Numrat maksimal në të kundërtën garantojnë që punëdhënësit punësojnë migrantë me kushte të këqija pune dhe paga të shtypura. Mungesa e të

drejtave të migrantëve domethënë mungesë e të drejtave të punëmarrësve. Kjo qon pashmangshëm tek përkeqësimi të marrëdhënieve në punë për të gjithë! Dhe e vështirëson integrimin e migrantëve.

Jo përjashtimit izolues

SVP-ja jo që dëshiron ti zgjidh problemet, ajo vetëm se krijon të reja. Qëllimi i saj është më shumë të përçajë punëmarrësit në migrantë dhe zviceranë, për të reduktuar e përkeqësuar edhe më tej kushtet e punës për të gjithë punëmarrësit. Me strategjinë e saj për të përhapë ksenofobinë, qojnë këtë vend pashmangshëm drejt mjerimit.

➔ Aurora Garcia

Unia do të zhvillojë një kampanjë votuese kundër iniciativës së SVP-së, e cila do të fillojë me rastin e ditës ndërkombëtare të migrantëve më 18 dhjetor me karta speciale (shih foton). Në muajin Janar do të intensifikohet aktiviteti edhe më tej. Angazhohuni edhe ju ne regjioni Tuaj!

Editorial



Më 9 shkurt do të votohet për iniciativën e SVP-së (shkurtesa në gjermanisht e Partisë Popullore të Zvicrës) «kundër imigrimit masiv». Shumë veta besojnë se më këtë iniciativë do të reduktohet imigrimi në Zvicër. Mirëpo ky nuk është fare qëllimi i vërtetë i SVP-së. Punëmarrësit duhet që edhe më tej të marrin punëtorë të cilët u nevojiten nga jashtë vendit. Nëse kalon iniciativa e SVP-së, atëherë do duhet anuluar marrëveshje me BE-në për lëvizjen e lirë të personave, me çka migrantet/ët nga BE-ja do të kishin më pak të drejta dhe më pak siguri qëndrimi në Zvicër. Me këtë rast në Zvicër do të mund të vinin vetëm ata migrantë, të cilët i nevojiten ekonomisë dhe nga momenti që nuk i nevojiten më tej, duhet të lëshojnë vendin.

Liria e lëvizjes së personave ka përmirësuar dukshëm pozitën juridike e njerëzve nga BE-ja. Qytetarët/ët e BE-së në Zvicër aktualisht janë të barabartë me qytetarët/ët e Zvicrës. Masat shoqërore mbrojtëse janë instrument i rëndësishëm për të luftuar dumpingun e pagave.

Migrantet/ët në rast të aprovimit të iniciativës do të jenë tërësisht të varur nga punëdhënësit e tyre. Ata nuk do të kenë mundësi të mbrohen nga trajtimi i padrejtë dhe as nga pagat e ulëta. Përsëri do të rritet edhe puna në të zeze me gjithë pasojat e saja negative. Qëllimi i vërtetë i fshehur pas kësaj iniciative nuk është të ketë më pak migrantë, por për të reduktuar të drejtat dhe pagat e migrantëve/ëve!

Andaj më 9 shkurt me bindje të plotë ne i themi JO iniciativës përjashtuese e izoluese të SVP-së.

Rita Schiavi

Anëtare e drejtorisë qendrore në Unia

News

Iniciativa për pagë minimale: Takimi i Unia-s më 7 shkurt

Unia organizon me 7 shkurt një manifestim mbi iniciativën për pagën minimale. Në qendër të vëmendjes janë përvojat që kanë bërë vendet tona fqinje me pagën minimale si dhe çështja përse është me përparësi paga minimale me ligj për tregun e punës në Zvicër. Ndër të tjerë do të referojnë Thorsten Schulte (nga sindikatat gjermane, instituti WSI), Frank Bsirke (ver.di), marc Chesny (Universiteti i Cyrihut) dhe Daniel Lampart (SGB). Pas tjerash janë paraparë punëtoritë dhe diskutimet me përfaqësues tjerë sindikatash. Manifestimi njëditor zhvillohet në Hotel Bern.

KKP e re për personelin shitës në Gjenevë



Në Gjenevë partnerët social, ndër të cilët edhe Unia, kanë nënshkruar një KKP (Kontrata Kolektive e Punës) e re e personelin shitës. KKP-ja rregullon posaçërisht pagat minimale të 17000 punonjësve dhe parashih një ngritje hap pas hapi në 4000 Franga: Kontrata e Gjenevës tani për tani është Kontrata e vetme në nivel Kantoni për tregtimin e imët. Së shpejti mund të pasojë Neuenburg-u.

Rritje e dobët pagash tek Migros-i

Unia në fillim të nëntorit shprehu zhgënjimin mbi komunikatën, përmes së cilës Migros-i bëri të ditur ngritjen e ulët individuale të pagave të punëtorëve. Me këtë rast humbet mundësia të shpërblejë punonjësit e Migros grupit për vitet e mbarë dhe së fundi edhe për arsyen se themeluesi i Migros-it Gottlieb Duttweiler do të arrinte moshën 125 vjeç.

...ashtu sikur edhe në Coop

Unia nuk ratifikon rezultatin e bisedimeve për paga 2014 me Coop-in. 425 milion arrin shuma e fitimit të Coop grupit për vitin 2012. ky rezultat i mirë kryesisht është arritur falë angazhimit të punonjësve. Mirëpo Coop nuk është gatshëm të shpërblejë angazhimin e madh të personelit të vet shitës porse parashih vetëm rritje individuale prej 1%. Kjo domethënë se punonjësit e Coop për vitin 2014 do të mbesin me gishta në gojë pasi nuk do të marrin ngritje pagash.

Kuvendi i delegatëve terciar

Më shumë mbrojtje dhe 4000 Franga pagë minimale

Më 11 nëntor u mbajt kuvendi i delegatëve të sektorit terciar, i cili vuri binarët për punën për vitet e ardhshme. Ndër të tjera delegatët aprovuan një rezolutë, përmes së cilës i kërkohet punëdhënësve të përmirësojnë kushtet e punës në këtë sektor të shërbimeve dhe të ngritën pagat në 4000 Franga.

Rreth 60 pjesëmarrës nga sektor të ndryshëm kontribuuan më 11 nëntor me angazhimin përmbajtësor në kuvendin e delegatëve terciar. Përmes diskutimeve, plotësimeve dhe ndryshimeve si dhe vendimeve për planin zhvillimor (EWP) 2013–2016 delegatët vunë binarët për zhvillimin e mëtejshëm.

Përpunimi i plani të ri i zhvillimor

Plani zhvillimor (EWP) 2013–2016 tani do të presohet drejtorisë qendrore të Unia-s dhe kryesisht qendrore ndërsa më pas duhet të konkretizohet dhe të zbatohet nga regjionet e veçanta në formë të planeve zhvillimore regjionale. Plani zhvillimor do të përqendrohet posaçërisht në temat vijuese: ngritjen e prezencës



Delegatët e Kuvendit të sektorit terciar kërkojnë më shumë mbrojtje dhe pagë minimale

nëpër ndërmarrje, veçanërisht në ngritjen e grupeve tjera të aktivistëve sindikal (personave të besuar), zgjerimin mbulues të KKP-ve dhe përmirësimin e KKP-ve ekzistuese, gjegjësisht përmirësimin e implementimit dhe të kontrolleve.

Bilanci dhe drejtimi i ri

Delegatët aprovuan bilancin në sektorin terciar për periudhën 2009–2012, raportin e aktiviteteve për vitin 2013 si dhe qëllimeve për vitin 2014 në sektorin terciar. Andreas Rieger

referoi nga libri «puna keqkuptuar». Atij me rastin e pjesëmarrjes së tij të fundit në kuvendin e delegatëve të sektorit terciar para pensionimit të rregullt iu dha lamtumira e përzier. Rishtas si drejtues në sektorin kombëtar delegatët zgjodhën Arnaud Bouverat dhe Muriel Chenuaux Mesnier.

Rezoluta «Më shumë mbrojtje dhe pagë minimale»

Në fund delegatët aprovuan rezolutën me titullin «Më shumë mbrojtje

dhe pagë minimale prej 4000 frange për të punësuarit në sektorin e shërbimeve». Me këtë rezolutë delegatët kërkojnë nga punëdhënësit jo vetëm të përmirësojnë kushtet e këqija dhe të pasigurta të punës dhe për fuqizimin e pagës minimale prej 4000 frangash, porse edhe përmirësim të të drejtave të sindikalistëve dhe kontrolle e thjeshtëzim të vlefshmërisë së përgjithshme të KKP-ve.

Aurora García

Dumpingu në paga, masat shoqëruese shtesë

Më shumë kontrolle dhe sanksione!

Gjithherë po vijnë të zbulohen raste të rënda të dumpingut. Të gjitha këto raste po tregojnë se punëmarrësit e pangopur mund të ndalen vetëm përmes intensifikimit të kontrollit dhe sanksioneve. Nevojitet fuqizimi i masave shoqëruese shtesë.

Një ndër rastet e dumpingut në pagë ndodhi në kantierin e Appartements Du Parc Kempinski në Mont Pélérin të Kantonit Waadt (VD). Rreth të 30 zdrukthëtarët e dërguar zhvilluan një grevë të mbështetur nga Unia. Ata kërkuan pagimin e pagave të papaguara. Pas tjerash ata denoncuan dumpingun në pagë të bërë nga punëdhënësit – të dërguarit paguheshin me një pagë prej 12–15 Euro në orë. Pas bisedimeve atyre iu paguan pagat bazuar në dokumentacionin e KKP-ve për sektorët ekonomik të punës si dhe harxhimet për ushqim.

Rasti në stacionin e trenit të Cyrihut

Një rast tjetër i madh u zbulua në tetor në stacionin kryesor të trenit në Cyrih. Përmes një sistemi të komplikuar të rrjetit të ndërmarrjeve nënkontraktuese mbi 30 punëmarrësve iu është dashur të kryejnë punë të rëndë për mbrojtjes nga zjarri me muaj të tërë për 5 deri 10 Euro në orë. Falë intervenimit të Unia-s Firma përgjegjëse nga Winterthur-i u obligua të merr përsipër pagesën e të gjitha pagave të munguara. Në fillim të muajit nëntor u bë pagesa e 13 punëmarrësve në shumën prej 428568 Frangave. Vet shuma e paguar tregon se nuk është fjala

për një kundërvajtje të vogël, porse për shkurtimeve sistematike të pagave vendore.

Mbi 10 000 nënshkrime për 10 ditë

Për shkak të rastit të Cyrihut Unia nisi një peticion me moton «Stop dumpingut të pagave – më shumë mbrojtje për pagat tona». Për vetëm

10 ditë u mblodhën 10656 nënshkrime. Peticioni kërkon nga qeveritari përgjegjës i Cyrihut Ernst Stocker një përgjigje publike në dy pyetje: Përse Enti për Punë dhe Ekonomi nuk përdorë të gjitha mjetet për ndalimin e dumpingut në paga; dhe, si do të mbrohen në të ardhmen pagat dhe kushtet e punës nga dumpingu i pagave.



Stacioni i trenit në Cyrih ku u zbuluan raste të dumpingut në pagë



Përgatitjet për aksionin kundër dumpingut në paga

Rasti i hotelit luksoz në Davos

Gjithashtu në nëntor u zbulua edhe një rast tjetër në kantierin e hotelit luksoz «Luxushotel International» në Davos. Katër suvatues gjoja të vetëpunësuar ishin të punësuar përmes një rrjeti të ndërmarrjeve nënkontraktuese. Si pasojë e mos pagesës së rrogave të katër punëtorët hasën në vështirësi serioze, ndërsa njeri nga punëtorët për shkak të situatës së shkaktuar stresuese pësoi edhe sulm në zemër. Pas kësaj ai iu drejtua Unia-s, e cila ia arriti, që të dy ndërmarrjet kontraktuese Baulink dhe Toneatti shprehën gatishmëri të paguajnë rrogat e papaguara.

Këshilltari federal i SVP-UDC-së bënë dumping në paga

Rasti i Davos-it tregon edhe hipokrizinë e SVP-UDC-së, e cila në njërën anë krijon disponim të keq kundër punëmarrësve të huaj, mirëpo në anën tjetër në mesin e vet ka ndërmarrje, të cilat po me këta punëmarrës bënë dumping të pagave. Pasi Këshilltari federal i SVP-UDC-së This Jenny është edhe kryetar i bordin të menaxherëve në ndërmarrjen Tonneatti. Në maj të vitit 2012 ai morri qëndrim kundër bashkëpërgjegjësisë solidarë.

Rastet e përmendura tregojnë posaçërisht se si rrjetet ndërmarrjeve nënkontraktuese në Zvicër minojnë në mënyrë sistematike kushtet e vlefshme të punës. Për të mënjeluar në të ardhmen keqpërdorimet nevojitet shtimi i masave mbrojtëse përcjellëse.

Aurora García

Unioni i Sindikatave Zvicerane

Pjesëmarrje e kënaqshme e aktivisteve dhe aktivistëve

Në vjeshtë si në çdo vjet u zhvillua konferenca e migracion në kuadër të Unionit të Sindikatave Zvicerane (SGB) si dhe kongresi i 12-të i grave të këtij Unioni. Në vijim do të japim një përmbledhje të shkurtë të këtyre dy manifestimeve.

Diçka është arritur mirëpo mbetet shumë për të bërë

Rreth 60 sindikalistë më 26 tetor u tubuan në Bernë në konferencën e Unionit të Sindikatave të Zviceranëve (SGB). Në qendër të vëmendjes posaçërisht ishte bilanci i programit rreth 4 vjet të vjetër të SGB-së për eliminimin e diskriminimit që ka të bëjë me migracionin. Përparime të caktuara janë arritur si p.sh. në çështjen e pagave minimale ose sa i përket zgjerimit të kurseve të ofruara gjuhësore. Kështu në vitet e fundit janë marrë parasysh rregullat antidiskriminuese në Kontratat Kolektive të Punës. Mirëpo në dosjen e njohjes së diplomave nuk janë bërë fare përparime. Pasdite pjesëmarrësit diskutuan temat e afërta praktike në grupet punuese. Përfundimi ishte se SGB si organizata më madhe në vend me programin e saj është në rrugë të mirë, mirëpo mbetet shumë punë për tu bërë, për të mundur integrimin aktiv të migrantëve në sindikatë dhe për të arritur barazinë e shanseve për të gjithë.

Barazi në paga – kontrole dhe sanksione tani

Të 200 delegatet e Kongresit të Grave të SGB-së, i cili zhvilloj punimet me 15 e 16 nëntor në Bernë nuk donë të pres më shumë: Punëdhënësit si



Pjesëmarrëse edhe ministria S. Sammaruga



Gjatë punimeve në Kongres



Pjesëmarrëse e përqendruar

duket nuk janë të gatshëm që vullnetarisht të zbatojnë barazinë në paga. Tani vlen vetëm implementimi i ligjit përmes kontroleve dhe sanksioneve. Edhe mysafirja referuese ministria federale Simonetta Sammaruga ishte e këtij mendim. Ajo tha se ka ndërmend të zbatojë masat shtetërore për të arritur barazinë në paga. Para përfundimit të vitit 2014 do ti bëhen pro-

pozime konkrete qeverisë federale. Krahas temës së barazisë në paga, Kongresi i grave të SGB-së, i cili kishte për moto «Punë të mirë – jetë të mirë! – Ne nuk do paguajmë krizën e juaj» u morr edhe me ndikimet që ka politika kursyese për gratë dhe me parakushtet e politikës së barazisë për «punën e mirë».

☞ Aurora García

Votimet popullore federale

JO iniciativës 1:12



Pamje nga manifestimi mbështetës i sindikalistëve për iniciativën 1:12

Populli zviceran më 24 nëntor 2013 tha tri herë JO. Iniciativa e familjes e SVP-së, e cila parashihte lehtësim në tatim për familjet, të cilat përkujdesen vet për fëmijët e tyre si dhe shtrenjtimi i taksës vjetore për autostradë u refuzuan. Mjerisht populli zviceran nuk aprovoi edhe iniciativën 1:12 të socialistëve të rinj.

Sindikata Unia shpreh keqardhje për refuzimin e iniciativës 1:12. Përmes kësaj initiative u arrit të zhvillohet diskutim i gjerë mbi pagat e drejta dhe ato të pajustificuara. Me Jo-në edhe në të ardhmen do të jenë të mundshme pagat e mashtruesve. Për të mbyllur deri diku hendekun e pagave, Unia edhe do të angazhohet me gjithë forcën për pagën minimale, i cila sipas parashikimeve

do të votohet në pranverë të vitit të ardhshëm. Pasi puna duhet t'ia vlejë për të gjithë njerëzit.

Të luftohen skandali i pagave të ulëta

Qysh tani kjo iniciativë do të do të debatohet në parlamentin e vendit, e cila sipas të gjitha gjasave do të votohet në muajin Maj 2014. Unia do të angazhohet me gjithë forcën bashkë



me anëtarësinë dhe me sindikatat tjera. Pasi vetëm me paga korrekte minimale mund të sigurohet se puna ia vlen për të gjithë dhe se mund të mënjanohet dumpingu ekstrem në paga.

☞ Aurora García

Intervistë



Rita Schiavi

Intervista, politika ndërkombëtare e migracionit

Migracioni si motor zhvillimor

Në vitin 2006 OKB-ja ka zhvilluar dialogun në nivel të lartë mbi migracionin dhe zhvillimin («High Level Dialogue on Migration and Development»). Ky dialog përfundoi pa një deklaratë të përbashkët. Më 3 e 4 tetor 2013 në Nju Jork u zhvillua dialogu i dytë, ku përfaqësuesit e qeverive dhe organizatave nga radhe e shoqërisë civile si dhe sindikatat shkëmbyen mes veti. Nga ishte pjesëmarrëse Anëtarja e drejtorisë qendrore të Unia-s. Në vijim ajo tregon për Horizonte përshtypjet e saja nga diskutimi në Nju Jork.

Rita, çka të ka bërë më së shumti përshtypje nga kjo Konferencë?

Migracioni në shumë vende shikohet si problem. Diskutimet në Nju Jork treguan më shumë të kundërtën: ato kërkuan zhvillimin dhe atë sikur në vendin e prejardhjes ashtu edhe në vendet e synuara: Bie shembulli Zvicra nuk mund të merret me mend pa migracion. Kush do të punonte përndryshe nëpër kantiere, kush do ti mirëmbante prindërit e sëmurë? Kryesisht njerëzit që kanë migruar. Pa ta nuk do të funksiononte infrastruktura jonë. Në duhet më në fund të shohim kontributin pozitiv, që jep migracioni në zhvillimin global.

Në çmasë ndihmon migracioni zhvillimin në vendin e prejardhjes?

Paratë e dërguara në Atdhe janë motor i madh i zhvillimit ekonomik për vendet amë. Ato ndikojnë me shumë se çdo ndihmë tjetër zhvillimore. Pasi tek ndihma klasike zhvillimore paratë binin në duar të gabuara dehe nuk shkonin tek ata që me të verbëte kanë nevojë. Paratë e dërguara arrijnë familjet drejtpërdrejtë, të cilat më pas këto para i harxhojnë në vendin e tyre. Ose këto para ndahen anash dhe si kursime shpesh përdoren për krijimin e ndërmarrjeve të vogla. Migracioni qon në shkëmbim më intensiv dhe zgjerim të rrjeteve: Edhe në vendin e synua njerëzit duan të konsumojnë prodhimet e vendit të prejardhjes. Kështu krijohen edhe marrëdhëniet tregtare. Shumë të kthyer nga vendi i synuar transferojnë njohuri e dije të dobishme si dhe kontakte në vendin amë.

Mirëpo po migrojnë edhe njerëz me arsimim të mirë, të cilët më pastaj mungojnë në vendin amë...

Po, ky është një problem. Dhe zviceranët përfitojnë nga kjo, pasi këtu vijnë profesionistë, pa pasur nevojë të investohet në arsimimin dhe aftësimin e tyre. Të mendojmë vetëm në mjekët, të cilët nga vendet tjera vijnë në Zvicër. Në gjermani bie shembulli qysh tani ka mungesë të mjekëve. Zvicra ka nënshkruar marrëveshje me Filipinet për të prurë në Zvicër personel infermier të arsimuar mirë.

Deri tani ishin posaçërisht organizatat humanitare, ato të cilat në vendet e migracionit merreshin me rrymat e migracionit. Tani janë aktive edhe sindikatat.

Në Zvicër qysh moti edhe GBI (Sindikata e Ndërtimit dhe Drurit) ka vërejtur se migrantët është me rëndësi të integrohen në sindikatë. Tani e shohin edhe sindikatat tjera nga vendet e migracionit se sa e rëndësishme është të njihen e çmohen migrantët edhe për përmirësimin e kushteve të punës. Organizatat ndërkombëtare të sindikatave janë aktivizuar edhe në kuadër të organizatave joqeveritare dhe kanë marrë pjesë aktive në Konferencën e dytë të OKB-së. OKB-ja për ne ka rëndësi, pasi ne përmes Organizatës Ndërkombëtare të Punës (IAO) mund të nënshkruajmë Marrëveshje ndërkombëtare, të cilat mund të kontribuojnë nëpërmirësimin e kushteve të punës.

18 janar 2014 tubimi për të ardhmen e mësimit të gjuhës amtare

Kurse për fëmijët e migrantëve dhe shumë-gjuhësia

Shumë fëmijë të migrantëve vijojnë kurset e gjuhës së prejardhjes dhe kulturës së tyre (shkurtesa në gjermanisht: HSK). Mirëpo këto kurse zhvillohen në kushte të vështira. Komuniteti i Gjuhës së Parë (shkurtesa gjermanisht: IGE) më 18 janar 2014 zhvillon një manifestim me qëllim që të intensifikojë diskutimin mbi të ardhmen e kurseve HKS.

Njohuritë mbi gjuhët dhe kulturat e tjera janë të kërkuara në botën e punës. Andaj vijimi i mësimit të gjuhës së prejardhjes është me rëndësi jo vetëm për marrëdhëniet me vendin prindërvë, porse edhe për shanset profesionale të fëmijëve dhe të rinjve të migrantëve.

Për Dario Mordasini, sekretar në qendrën e Unia-s, i cili përpara ishte përgjegjës për kurset në italisht të HSK-së tek fondacioni ECAP në Bazel, aspektet pozitive peshojnë dukshëm më shumë për përfundimin e gjuhës dhe kulturës sonë personale në krahasim me ngarkesën shtesë që paraqet vijimi i këtyre kurseve: «Unë gjithmonë kam bërë përvojën se për shumë të rinj vijimi i këtyre kurseve kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e shanseve arsimore si në Zvicër ashtu edhe në vendin amë».

Ndahen përvoja të njëjta

Edhe në aspektin social këto kurse kanë rëndësi qendrore. Aurora Garcia, sekretare për migracion në Unia, ka vijuar kurset spanjolle në rini. Dhe i ka dashur ato: «Aty unë kisha mundësinë të njohë njerëz tjerë moshatarë dhe me të njëjtat histori migracioni. Unë nuk isha edhe e izoluar dhe anësore, porse ndër të njëjtat, të cilët


kanë përjetime të ngjashme. Kjo ishte e bukur.»

Kurset në rrezik

Edhe përkundër rëndësisë së këtyre kurseve, kornizat dhe sigurimi i kualitetit lenë për të dëshiruar përmirësime të caktuara. Mes Kantoneve ekzistojnë dallime të mëdha. Mirëpo edhe mes gjuhëve. Dhe pjesërisht kurset janë vu në pikëpyetje edhe për shkak të problemeve financiare.

Manifestimi më 18 janar 2014

Përmes Takimit në janar 2014 IGE-ja dëshiron debati mbi kurset e ofruara të mësimit të HSK-ve dhe përfshirja e shumë-gjuhësisë të pasurojë mësimet. Aspekti i fundit është i rëndësishëm së jashtëzakonshme, është i bindur Dario Mordasini. Për atë përvojat do të ishin «posaçërisht pozitive nëse bëhet i mundur bashkëpunimi i ngushtë dhe institucionalizimi i këtij bashkëpunimi mes mësimdhënësve të HSK-ve dhe personelit mësimor të shkollave zvicerane».



Lajmërimi për manifestimin: www.linguaprime.ch/index.php?id=24

⇒ Marilia Mendes

«Komuniteti i Interesit të Gjuhës së Parë» (IGE) angazhohet që zhvillimi i gjuhëve të para të fëmijëve të familjeve migrante të perceptohet si detyrë qendrore të arsimi publik dhe si e tillë edhe të ankorohet. Unia mbështet IGE-në dhe merr pjesë konsiderueshëm në organizimin e manifestimit. Për më shumë informacione shih: www.linguaprime.ch



Reka & Unia

Me çeqet Reka pushim me zbritje

Anëtarë e Unia-s me familjet e tyre përfitojnë nga zbritjet edhe për 25%

Anëtarët e Unia-s përfitojnë nga zbritjet Raka. Shfrytëzoni çeqet për pushime skish, për qira pushimorësh apo si para udhëtimit me zbritje.

Në fund të vitit përmes postës merrni shkresën e Arkës së udhëtimitve Reka bashkë me dëftesën për pagim. Përmes saj ju keni mundësi të blini me zbritje çeqe Reka në shumë prej 500 Frangave, të cilat në shumë vende mund të përdoren si mjet pagese. Reka jep me qira rreth 3000 banesa pushimi me zbritje në Zvicër dhe jashtë saj. Përmes Unia-s këto banesa pushimi keni mundësi të merrni më lirë edhe për 10% tjera.

1 javë pushim = 100 Franga
Edhe ata që kanë buxhet të paktë duhet të kenë mundësinë të pushojnë me tërë familjen. M një çmim simbolik prej vetëm 100 Frangave mund të kaloni pushimet në njërin nga banesat e pushimit të Raka-s: Kriteret e përzgjedhjes mund të mësoni tek Unia apo drejtpërdrejt në faqen e internetit www.reka.ch.

Pos tjerash Unia ka hotele partnere të ndryshme. Për anëtarë dhe familjet e tyre në to ka zbritje deri 25%. Pushime të këndshme. Informata të detajuara gjeni ose nën

www.reka.ch, ose drejtpërdrejt në sekretariatit Tënd të Unia-s. Pushimoret e Reka-s i gjeni gjithashtu në internet nën <http://goo.gl/m7E4V>, ndërsa Hotelet e Unia-s në adresën <http://goo.gl/VOIUC>.

⇒ Sina Bühler



Përfitoni nga pushime të lira



Ju pyesni, Unia përgjigjet



Humbja e vendit të punës: A marr para nga sigurimi i papunësisë deri në moshën e pensionimit?

Unë punoi ka 15 vjet tek një firmë, e cila ka një kohë që gjithmonë e më pak merr porosi pune. Shefi im sot para mbledhjes me personelin e firmës paralajmëroi se ai në kuadër të një restrukturim duhet të shkarkoj 20 veta. Unë jam 62 vjeç dhe kam drojë se do të më shkarkoj nga puna dhe se unë për shkak të moshës sime nuk do të mund të gjej punë tjetër. A mund të më thonë për sa kohë mund të marrë kompensimin papunësie, nëse humbi vendin e punës?

Po. Personat, të cilët në 2 vitet e fundit para papunësisë së tyre kanë punuar më shumë se 12 muaj dhe kanë kaluar moshën 55 vjeç kanë të drejtën për 520 ditë para ditore nga Sigurimi i Papunësisë. Pasi që ju në 4 vitet e fundit para arritjes së moshës së pensionimit të rregullt lajmërohet si i papunë, fiton të drejtën edhe të 120 ditëve shtesë së pagës ditore. Me 62 vjet për ju rezultojnë 640 ditë të pagës ditore. Kjo i përgjigjet një përfitim të kontributeve për më shumë se dy vjet. Varësisht nga datëlindja pra mund të jetë, se ju përfitoni nga e drejta e kompensimit të papunësisë deri në arritjen e moshës së pensionit të rregullt.

Megjithatë ju duhet ti përmbushni të gjitha obligimet karshi Sigurimit të Papunësisë. Për shembull ju duhet të përqipeni aktivisht të gjeni një vend pune. Kjo është me rëndësi, pasi edhe njerëzit e moshuar ka gjithnjë shanse për tu integruar në tregun e punës.

Timur Öztürk, work, 14.11.2013

Presion i madh: Nëse e prishi kontratën a do gjobitem nga sigurimi i papunësisë?

Unë punoj tek një firmë e cila ka vite që punëson gjithnjë e më pak punëtorë. Pasi që punëtorët e larguar nuk zëvendësohen, punëtorët e mbetur duhet që të punojnë gjithmonë e më shumë. Orët e tepërta të punës dhe presioni i lartë në punë më qojnë në kufijtë e limiteve të mija: më është dashur shumë herë të shkoj tek mjeku për shkak të pengesave në gjumë dhe ankesave në frymëmarrje. Pasi që nuk po mund të durojë këtë gjendje, jam duke menduar të largohem nga puna. A duhet të llogariti në sanksione nga ana e Sigurimit të papunësisë?

Jo, nëse mjeku juaj vërteton me dëftesë se për shkaqe shëndetësore puna e tillë nuk është e arsyeshme dhe se ju për këtë arsye po prishni kontratën e punës. Nëse mungon një vërtetim i tillë i mjekut, juve në fillim të papunësisë suaj mund të ju shkurtohen disa ditë të parave ditore. Në thelb vlen: kush lëshon një vend pune të arsyeshëm, do të gjobitet me heqje të ditëve të caktuara të parave ditore. Për të vlerësuar sa a është e arsyeshme prishja e kontratës së punës aplikohen kritere të rrepta. Kështu vlejnjë orët e tepërta që nuk kalojnë lartësinë e lejuar ligjore si të arsyeshme. Andaj bisedoni me mjekun tuaj para se të jepni dorëheqje nga puna. Vetëm me vërtetimin mjekësor mund ti mënjanoi sanksionet e Sigurimit të Papunësisë. Më rëndësi është që të përqipeni seriozisht të gjeni një vend pune: Qysh gjatë afatit të dorëheqjes duhet të shkruani aplikacione për kërkim të vendit të punës. Pasi kushdo që angazhohet pamjaftueshëm për të gjetur punë do ti shkurtohen ditët e përfitimt.

Timur Öztürk, work, 14.11.2013

Impressum: **Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Ringier Print, Adligenswil | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch